



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Raport Vjetor 2016



Versioni 1.0

Nr. Ref: ASHNA-RVJ2016

Data e Ver.: 24.03.2017



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 24.03.2017

Faqe 1 nga 59



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Shkurtesat

Shkurtesa	Kuptimi
AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
ABR	Auditori i Brendshëm
AIP	Aeronautical Information Publication
ANP	Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
BE	Bashkimi Evropian
DBNJ	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DCSS	Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
DFIN	Departamenti i Financave
DMS	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (<i>Document Management System</i>)
DZHT	Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IATA	Organizata Ndërkombëtare e transportuesve Ajror
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
DKNV	Departamenti për Komunikim Navigim Survejim
KCSS	Komiteti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
KFOR	Kosovo Force (Forca e Kosovës - NATO)
DKTA	Departamenti Kontrolli i Trafikut Ajror
DMET	Departamenti Meteorologjik
MMC	Manuali për Menaxhimin e Cilësisë
MMS	Manuali për Menaxhimin e Sigurisë
MO	Mirëmbajtja e objekteve
MTA	Menaxhimi i Trafikut Ajror
MVS	Metodologjia për Vlerësim të Sigurisë
OJT	On Job Training (Praktika në punë)
PSSA	Vlerësimi Preliminar i Sigurisë së Sistemit
SMATSA	Agjencia Serbe e Navigimit Ajror
SKR	Skema për Klasifikim të Rrezikut
SMC	Sistemi për Menaxhim të Cilësisë
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
SSA	Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit
SHIA	Shërbimet e Informatave Aeronautike
SHTA	Shërbimet e Trafikut Ajror
TI	Teknologjia Informative
ZYDR	Zyra e Drejtorit
ZVAF	Zëvendës Drejtor për Shërbime Administratë dhe Financa
ZVOP	Zëvendës Drejtor për Shërbime Operative



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 2 nga 59



Përmbajtja

Shkurtesat.....	2
Përmbajtja.....	3
Lista e figurave.....	5
Lista e tabelave.....	6
Hyrje.....	7
1. Ngjarjet kryesore të periudhës raportuese të mbuluar nga ky raport	8
1.1 Çertifikimi i ASHNA.....	9
1.2 Procesi i normalizimit të hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës.....	10
1.3 Mbledhja “ Balkans Airspace Normalization Meeting” (BANM)	13
1.4 Nxjerrja dhe miratimi i akteve të brendshme.....	14
1.5 Vendimi Ekzekutiv për tarifën njësi terminale 2017.....	19
1.6 Auditimet	20
1.7 Trajnimet e personelit.....	22
2. Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës	26
2.1 Indikatorët e performancës së sigurisë	26
2.2 Operimet	27
2.2.1 Operimet Komerciale	28
2.3 Lloji i fluturakeve në ANP “Adem Jashari”.....	31
2.4 Kompanitë Ajrore prezente në ANP.....	32
3. Pasqyra e performansës financiare dhe rezultatet.....	34
3.1 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.....	35
3.2 Raporti i ekzekutimit të buxhetit	36
3.2 Mallra dhe shërbime.....	37
3.3 Shpenzime kapitale.....	38
3.4 Të hyrat e dedikuara	39
3.5 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit.....	41





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

3.6	Raport për të arkëtueshmet	42
3.7	Raport për detyrimet (faturat) e papaguara	43
3.8	Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)	45
3.9	Raport për të hyrat e dedikuara për bartje	46
3.10	Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave.....	46
4	Progresi me planin e punës.....	47
4.1	Progresi me planin e punës në aspektin e Sigurisë	47
4.2	Progresi me planin e punës në aspektin e Cilësisë	52
4.3	Progresi me planin e Punës në aspektin e Sigurimit.....	53
4.4	Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë.....	54
5.	Shpenzimet kapitale dhe projektet.....	55
6.	Perspektiva për periudhën Raportuese të ardhme.....	57
7.	Rreziqet e së ardhmes të ASHNA	59



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 4 nga 59



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Lista e figurave

Figura 1: Takimi i Menaxhmentit të ri me Ministrin e Infrastrukturës.....	8
Figura 2: Çertifikimi i ASHNA nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës – Gusht 2016.....	9
Figura 3: Kufizimet aktuale në hapësirën ajrore të Kosovës.....	10
Figura 4: “Rrugët” ajrore të Republikës së Kosovës.....	11
Figura 5: "Rrugët" ajrore që pritet të hapen.....	13
Figura 6: Manuali për Menaxhimin e Cilësisë (MMC) - Versioni 2.0.....	14
Figura 7: Statuti i Njësisë së Auditimit të Brendshëm - Versioni 1.0.....	15
Figura 8: Manuali për Menaxhimin e Uebfaqes së ASHNA-së - Versioni 1.0.....	16
Figura 9: Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm në ASHNA (RRB).....	17
Figura 10: Niveli i kënaqësisë me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga ASHNA për vitin 2016.....	18
Figura 11: Struktura aktuale ajrore dhe korridoret ajrore.....	19
Figura 12: Auditimi nga EASA (European Aviation Safety Agency) – Nëntor 2016.....	20
Figura 13: Çertifikimi me sukses i personelit meteorologjik në UK Met Office College.....	22
Figura 14: Trajnimi "OJTI Refresher" në ASHNA - Gusht 2016.....	23
Figura 15: Vizitat e shumta të nxënësve në ASHNA.....	25
Figura 16: Ndodhitë dhe kategorizimi i tyre përgjat vitit 2016 në ASHNA.....	26
Figura 17: Koordinimi Civilo-Ushtarak.....	27
Figura 18: Operimet Komerciale në baza vjetore.....	28
Figura 19: Operimet ushtarake në baza mujore.....	29
Figura 20: Operimet VFR në baza mujore.....	30
Figura 22: Krahasimi 2015 - 2016 i llojit të fluturakeve, operuar në ANP "Adem Jashari".....	31
Figura 23: Krahasimi i Kompanive Ajrore prezente në ANP, 2015 - 2016.....	33
Figura 24: Objektivat e ASHNA-s në periudhën afatmesme.....	57
Figura 25: Infrastruktura aktuale.....	58



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 5 nga 59



Lista e tabelave

Tabela 1: Vlerësimi nga IATA.....	11
Tabela 2: Llojet e detyrave dhe aktiviteteve të auditimit për vitin 2016.....	21
Tabela 3: Operimet Komerciale 2015 – 2016.....	28
Tabela 4: Operimet ushtarake të menaxhuara.....	29
Tabela 5: Operimet VFR 2015 - 2016.....	30
Tabela 6: Krahasimi ndër vite me nr. e llojeve të fluturakeve.....	31
Tabela 7: Kompanitë Ajrore me mbi 20 fluturime në ANP "Adem Jashari".....	32
Tabela 8: Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme.....	35
Tabela 9: Ekzekutimi i buxhetit.....	36
Tabela 10: Mallra dhe shërbime.....	37
Tabela 11: Shpenzimet kapitale.....	38
Tabela 12: Të hyrat e dedikuara.....	39
Tabela 13: Ndarjet fillestare dhe finale të buxhetit.....	41
Tabela 14: Të arkëtueshmet.....	42
Tabela 15: Detyrimet e papaguara.....	43
Tabela 16: Pasuritë kapitale.....	45
Tabela 17: Të hyrat e dedikuara për bartje.....	46
Tabela 18: Numri i punëtorëve sipas listës së pagave.....	46
Tabela 19: Progresi me planin e punës në aspektin e Sigurisë.....	51
Tabela 20: Progresi me planin e punës në aspektin e Cilësisë.....	52
Tabela 21: Progresi me planin e Punës në aspektin e Sigurimit.....	53
Tabela 22: Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë.....	54
Tabela 23: Kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2016.....	56





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Hyrje

Raporti vjetor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror përfshin aktivitetet e Agjencisë përgjatë vitit kalendarik 2016.

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) është themeluar me ligjin Nr. 04/L-250, miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 20.03.2014; shpallur me dekretin Nr. DL-010-2014, datë 07.04.2014 nga ish-Presidentja e Republikës së Kosovës - Atifete Jahjaga; Shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 28.04.2014 dhe hyrë në fuqi 15 ditë më vonë, gjegjësisht më 14.05.2014.

Me fillimin e aplikimit të këtij ligji në fuqi që nga: 01.01.2016, ASHNA të gjithë shfrytëzuesve ka filluar t'u ofrojë shërbimet e navigacionit ajror civil të cilat deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji i ofronte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"- Kontrolli Ajror.

ASHNA vazhdimisht bënë përpjekje për të zbatuar një komizë të menaxhimit të trafikut ajror e cila është e bazuar në standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) si dhe legjislacionit të Komisionit Evropian dhe përqëndrohet në përmirësimin e performansës së sigurisë, duke minimizuar ndikimin negativ ndaj mjedisit, duke ngritur kapacitetet që janë në përputhje me kërkesat e trafikut ajror, si dhe duke optimizuar efikasitetin e fluturimit dhe duke përmirësuar efikasitetin e kostos.

Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror rajonal dhe Evropian si dhe më gjerë, në shumicën absolute të rasteve pranojnë një përqindje të vogël të të hyrave nga hapësira e ulët ajrore. Ndërsa, shumicën absolute të të hyrave i sigurojnë nga menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore. Për shkak të pamundësisë së ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror edhe në hapësirën e lartë ajrore, dhe vjeljen e të hyrave nga kjo hapësirë, ASHNA është në pozitë tejet të disfavorshme në aspektin e nivelit të të hyrave krahasuar me ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror rajonal dhe evropian. Menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore për ASHNA-n do të mundësonte ofrim të normalizuar të shërbimeve.

Edhe këtë vit, gjendja jo e mirë financiare e trashëguar edhe nga statusi i ASHNA-së në të kaluarën ka qenë si pasojë e çështjeve të trashëguara gjyqësore në lidhje me eksproprijimin e pronave private dhe e proceseve tjera gjyqësore në lidhje me ankesat e punëtorëve të larguar në të kaluarën para procesit të koncesionimit të ANP-së.



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 7 nga 59



1. Ngjarjet kryesore të periudhës raportuese të mbuluar nga ky raport

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ofron shërbime brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" siç përshkruhet edhe në Publikimin Aeronautik të Republikës së Kosovës (AIP).

Objektivat kryesore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror janë:

- Ofrimi i Shërbimeve të Trafikut Ajror (ATS);
- Ofrimi i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik (AIS);
- Ofrimi i Shërbimeve të Komunikimit, Navigimit dhe Survejimit Aeronautik (KNV);
- Ofrimi i Shërbimeve Meteorologjike (MET);
- Koordinimi i veprimeve me njësitë e kërkim-shpëtimit në rast të aksidenteve të avionëve brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Mbështetur në ligjin mbi ASHNA me Nr. 04/L-250, neni 6 dhe neni 8, me vendimin me Nr. 06/98, Datë: 29.06.2016, Qeveria e Republikës së Kosovës ka emëruar Drejtorin, Zv.Drejtorin për shërbime administrative financiare dhe Zv. Drejtorin për shërbime operative të ASHNA me një mandatë 5 vjeçarë.



Figura 1: Takimi i Menaxhmentit të ri me Ministrin e Infrastrukturës





1.1 Çertifikimi i ASHNA

Çertifikimi i ASHNA ka qenë proces i nisur shumë më herët por që ka përfunduar në muajin Gusht të vitit 2016. Me këtë rast ASHNA është çertifikuar si organizatë për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, që përmbush Kërkesat e Përbashkëta për këto shërbime:

ATS – CNS – AIS – MET

Çertifikata ka një validitet prej 5 vitesh.




Figura 2: Çertifikimi i ASHNA nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës – Gusht 2016





1.2 Procesi i normalizimit të hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës

Hapësira e ulët ajrore e Republikës së Kosovës shtrihet nga toka deri në lartësi 6,250 metra. Kjo hapësirë kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror e Kosovës, nën mbikëqyrjen rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Shërbimet në këtë hapësirë përfshijnë të gjitha fluturimet për në dhe nga ANP “Adem Jashari”, fluturimet ushtarake të KFOR-it në Kosovë dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm.

Që nga përfundimi i luftës, fluturimet civile mund të hyjnë dhe dalin nga Kosova vetëm përmes korridorit ajror që e lidhin vendin tonë me Maqedoninë. P.sh. një aeroplan që fluturon nga Vjena në Prishtinë, duhet të bëjë një rrugë rreth 250 km apo 15-20 minuta më të gjatë, sepse është i detyruar të fluturojë përmbi Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni për të hyrë në Kosovë. Deri më tash, NATO-ja nuk ka lejuar hapjen e korridoreve ajrore me shtetet tjera fqinje (Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë).



Figura 3: Kufizimet aktuale në hapësirën ajrore të Kosovës





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency




Figura 4: “Rrugët” ajrore të Republikës së Kosovës

Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, do të përfshinte hapjen e korridoreve të reja ajrore midis Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendeve fqinje (Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë), që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP “Adem Jashari”. Korridoret e reja ajrore do ta shkurtonin kohën e fluturimit për rreth 15-20 minuta, do ta ulnin koston e operimit për kompanitë ajrore, që rrjedhimisht, do të duhej të reflektohej në bileta më të lira për udhëtarët tanë.

Njësia	Ditore	Vjetore
Numri i fluturimeve	28 fluturime	10.220 fluturime
Distanca e zvogëluar	2000-3700 nm	730.000-1.35m NM
Koha e zvogëluar	15 min-29 min	153.300-296.300
Karburanti i zvogëluar	10.6-20 ton	3870-7300 ton
Ulja e Co2	34.5-65 ton	12.590-23.725 ton

Tabela 1: Vlerësimi nga IATA



Njësia Organizative: ZYDR
 Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
 Ver.: 1.0
 Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 11 nga 59



Ky normalizim do të mundësonte edhe mbikalimin transit nëpër hapësirën tonë të ulët ajrore të shumë avionëve që fluturojnë në aeroportet tjera të rajonit (p.sh. Tirana, Podgorica, Shkupi, Selaniku, Nishi). Nga kjo do të ketë përfitime të ndjeshme financiare për Agjencinë tonë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, pasi që parashikohet që me normalizimin e hapësirës sonë të ulët ajrore, në këtë pjesë të hapësirës tonë do të mbikaloni rreth 12-15 mijë fluturime në vit (përafërsisht 600,000-750,000 euro të hyra shtesë). Përveç kësaj, rrugët më të shkurtra ajrore do ta bëjnë ANP "Adem Jashari" më konkurrent në rajon dhe më joshës për kompanitë ajrore për shkak të kostos më të ulët të operimit.

Më 18 janar 2016, me kërkesë të Stafit Ndërkombëtar të NATO-s, është mbajtur një takim midis Stafit Ndërkombëtar të NATO-s dhe delegacionit të Republikës së Kosovës, të udhëhequr nga Ministrija Edita Tahiri, si vazhdim i takimit paraprak të mbajtur më 3 dhjetor 2015 në Shtabin Qendror të KFOR-it, në Prishtinë. Qëllimi i takimit ishte prezantimi nga NATO-ja i hapave të planifikuar të radhës në procesin e normalizimit të hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, në kuadër të procesit BANM, të udhëhequr nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s. Në këtë takim NATO-ja i ka ftuar edhe përfaqësuesit e Serbisë dhe të BE-së. Si hap i parë në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, me qëllim të caktimit të pikave-hyrëse dhe dalëse dhe transferit të aeroplanëve në fluturim midis Kosovës dhe vendeve fqinje, kërkohet hartimi dhe zbatimi i marrëveshjeve midis Agjencisë kosovare të Shërbimeve të Navigacionit Ajror me agjencitë homologe fqinje (SMATSA - Serbi dhe Mal i Zi, Albcontrol - Shqipëri, M-NAV - Maqedoni), në koordinim të ngushtë me ICAO-n dhe EUROCONTROL-in. NATO-ja kërkon që ky proces të udhëhiqet dhe lehtësohet prej tyre, në përputhje me mandatin që e kanë në hapësirën ajrore të Kosovës.

Edhe Ligji i aplikueshëm në Republikën e Kosovës e njeh mandatin e NATO-s në hapësirën tonë ajrore. Sipas nenit 25.5 të Ligjit 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, "Hyrja në fuqi këtij ligji nuk i heq autoritetin e dhënë Organizatës Veri-Atlantike (NATO) në lidhje me hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës".

NATO-ja ka caktuar takime të ndara dypalëshe me përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës. Takimi me Qeverinë e Serbisë në Beograd do të mbahet më 23 shkurt 2016.

Në këto takime NATO-ja pritet të kërkojë përkrahjen politike të Qeverive të Kosovës dhe të Serbisë për fillimin e dialogut teknik midis ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror të të dy vendeve, të lehtësuar nga NATO-ja. Nëse ka miratim politik nga dy Qeveritë, NATO-ja planifikon ta organizojë dhe lehtësojë një seri takimesh teknike midis ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror gjatë marsit dhe prillit 2016, para se të mbahet mbledhja e radhës BANM. Sipas NATO-s, në këto takime teknike do do të bisedohet për caktimin e pikave hyrëse-dalëse midis hapësirave ajrore të Kosovës dhe Serbisë (demarkacion ajror v.j.); procedurat e trafikut ajror për transferimin e aeroplanëve në fluturim nga hapësira ajrore e Kosovës në hapësirën ajrore të Serbisë dhe anasjelltas; definimin e hapësirës së ulët ajrore; vlerësimet e sigurisë dhe përcaktimin e nevojave për trajnime.





1.3 Mbledhja “ Balkans Airspace Normalization Meeting” (BANM)

Më 14 dhjetor 2016, në Shtabin Qendror të NATO-s në Bruksel, është mbajtur mbledhja e radhës për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (Balkans Airspace Normalization Meeting – BANM), organizuar nga Stafi Ndërkombëtar I NATO-s. Nga Republika e Kosovës, në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës, Autoritetit të Aviacionit Civil, Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe Atasheu ynë i mbrojtjes për Beneluks, poashtu në takimet e tilla që organizohen në mënyrë periodike marrin pjesë edhe autoritetet aeronautike të shteteve të Ballkanit, organizatat relevante ndërkombëtare (ICAO dhe Eurocontrol), Komisioni Evropian, asociacioni I kompanive ajrore (IATA) si dhe përfaqësues civilë e ushtarak të misioneve të shteteve në NATO. Një nga pikat e diskutimit të kësaj mbledhje, ishte edhe normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës (deri në lartësi 6,25 km). Vlenë të theksohet se deri në këtë takim, autoritetet serbe nuk kanë qenë të gatshme të përkrahin procesin e hapjes së korridorit ajror Kosovë – Serbi, fillimisht me arsyetim se kërkojnë më shumë qartësi ligjore dhe politike dhe më pas për shkak se hapjen e këtij korridori nuk e kanë prioritet.

Për të qenë në përputhje me qëndrimin e vet neutral rreth statusit të Kosovës, NATO-ja e ka identifikuar si alternativën më të përshtatshme nënshkrimin e një Marrëveshjeje Teknike midis ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror të Kosovës, Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë, me një shënim me referencë në NATO-BE-UNMIK. Sipas NATO-s, kjo alternativë i ka këto përparësi: është në përputhje me dialogun dypalësh të lehtësuar nga BE-ja, është e thjeshtë, teknike dhe rutinore.

Bazuar në rrjedhën e takimit, në fund të mbledhjes, NATOja i informoi pjesëmarrësit se takimi i ekspertëve të ASHNA-s dhe SMATSA-s planifikohet të mbahet në Podgoricë në pjesën e dytë të janarit 2017. Nikoqir do të jetë AAC-ja e Malit të Zi, ndërsa takimi do të lehtësohet nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s.




Figura 5: "Rrugët" ajrore që pritet të hapen





1.4 Nxjerrja dhe miratimi i akteve të brendshme

Në periudhën pas marrjes së përgjegjësisë nga menaxhmenti i lartë, me qëllim të krijimit të bazës së brendshme rregullative mbi funksionimin e ASHNA sipas ligjit mbi ASHNA me Nr. 04/L-250, janë përpiluar dhe miratuar një mori dokumentesh të brendshme të cilat do ti paraqesim në vijim:

Manuali për Menaxhimin e Cilësisë (MMC)

Qëllimi i këtij Manuali është që të përcaktojë politikat dhe metodën e zbatimit të Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë (SMC) në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).

Të gjitha politikat dhe procedurat e shkruara të njësive organizative apo veprimet e tyre sipas këtij manuali duhet të përshtaten dhe të jenë në përputhshmëri të plotë me politikat e paraqitura në këtë Manual. Të gjitha ndryshimet në politika dhe procedura relevante të ASHNA-s duhet të rishikohen për t'u siguruar që nuk ka ndonjë mospërputhje apo konflikt me Manualin e Menaxhimit të Cilësisë (MMC).



Figura 6: Manuali për Menaxhimin e Cilësisë (MMC) - Versioni 2.0





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Statuti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Ky statut është nxjerrë në bazë të neneve 7 dhe 9 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe nenit 14 pika 2.15 të Ligjit nr. 03/L-128 mbi Auditimin e Brendshëm si dhe pikë 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm.

“Auditimi i brendshëm” (AB) është aktivitet i pavarur, për të ofruar siguri objektive dhe këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës. AB i ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave të saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.



Figura 7: Statuti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm - Versioni 1.0



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 15 nga 59



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Manuali për Menaxhimin e Uebfaqes së ASHNA-së

Qëllim i këtij Manuali është që të përcaktoj standardet për menaxhimin, formën, përmbajtjen dhe azhurnimin e uebfaqes, si dhe harmonizimin me kërkesat që dalin nga Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për Uebfaqet e Institucioneve publike.

Ky manual përfshinë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që ndërmirren për një funksionim sa më efikas të uebfaqes së ASHNA. Këto veprime përfshijnë, mirëpo duke mos kufizuar, të gjitha obligimet për publikimin e të dhënave apo dokumentacionit të ASHNA-së, të cilat ASHNA obligohet nëpërmjet ligjeve në fuqi, që ti publikojë në uebfaqen e ASHNA-së.




Figura 8: Manuali për Menaxhimin e Uebfaqes së ASHNA-së - Versioni 1.0



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 16 nga 59



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm në ASHNA (RRB)

Në zbatim të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-250 për ASHNA, është nxjerrë kjo rregullore e cilla rregullon:

1. Organizimin dhe funksionimin e ASHNA-s, definimin e njësive të brendshme, menaxhimin e tyre, kompetencat dhe përgjegjësitë, si dhe raportet në strukturë; dhe
2. Përshkrimin e detyrave, funksionet dhe emërtimet e tyre.



Figura 9: Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm në ASHNA (RRB)



Njësia Organizative: ZYDR
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-RVJ2016
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 15.03.2017

Faqe 17 nga 59



Raporti për Kënaqësinë e Konsumatorit

Me qëllim të përmbushjes së nenit 16, pika 1.8; 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ASHNA ka hartuar një pyetësorë me anë të të cilit ka bërë vlerësimin e kënaqësisë së klientëve me shërbimet e ofruara nga ASHNA-ja për vitin 2016.




Figura 10: Niveli i kënaqësisë me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga ASHNA për vitin 2016

Në bazë të rezultateve të dalta nga ana e hulumtimit, si dhe gjatë komunikimit direkt me përfaqësuesit e kompanive ajrore, është vërejt një nivel i lartë i kënaqësisë me shërbimet e ofruara nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. I gjithë ky rezultat është arritur falë përgatitjes dhe angazhimit të të gjithë stafit të ASHNA-së, me të vetmin qëllim që, operimi në Hapësirën Ajrore të Republikës së Kosovës të jetë në nivelin më të lartë të sigurisë dhe shërbimeve cilësore. ASHNA është e përkushtuar në realizimin e misionit dhe vizionit të sajë.





1.5 Vendimi Ekzekutiv për tarifën njësi terminale 2017

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.215.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr.03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, datë 10 shkurt 2016 (“Rregullorja”) dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, 28 prill 2014), si dhe duke konsideruar riaplikimin e ASHNA-së, nr. Protokoli, 0106, dt. 23 dhjetor 2016, për tarifën njësi terminale për vitin 2017, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës përmes një vendimi (Nr.11/ZDP/VE/2016) me dt. 30 dhjetor 2016, ka përcaktuar tarifën njësi terminale 2017 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 346 EUR, tarifë kjo që u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës (Aeroporti Nërkombehtar i Prishtinës “Adem Jashari”) dhe e cila aplikohet që nga 01 janar 2017.

Bazuar nga ky vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, ASHNA është obliguar që të inicojë amendamentimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me LIMAK Kosovo International Airport mbi mbledhjen dhe depozitimin e tarifave të ASHNA-s, të nëshkruar në maj 2011.




Figura 11: Struktura aktuale ajrore dhe korridoret ajrore





1.6 Auditimet

Gjatë vitit 2016 në muajin Qershor i jemi nënshtruar auditimit nga AACK, me çrast është përgaditur plani për mbylljen e gjetjeve të dala nga ky auditim.

Në muajin Tetor divizioni i sigurimit është audituar nga MPB dhe është përgaditur plani i veprimit për mbylljen e gjetjeve të dala nga ky auditim.

Në muajin nëntor jemi audituar nga EASA si pjesë e auditimit që EASA ka realizuar në AACK.

Gjithashtu Njësia e Auditimit të Brendshëm në ASHNA gjatë vitit 2016 ka planifikuar realizimin e 7 auditimeve të brendshme dhe aktiviteteve të auditimit.

Vizita dhe auditimi nga EASA

EASA ka bërë një auditim ndaj AACK, ku si rrjedhojë edhe një audit të shkurtër në ASHNA. Auditimi ka nxjerrë në pah deficitet në pjesë të ndryshme të sistemit, në të cilat kërkohet investim i gjithanshëm. Auditimi në përgjithësi ka rezultuar i suksesshëm me disa gjetje për të cilat ekziston një plan përmbyllës në kordinim me AACK.



Figura 12: Auditimi nga EASA (European Aviation Safety Agency) – Nëntor 2016





Auditimet e brendshme nga Njësia e Auditimit të Brendshëm

Auditimet dhe aktivitetet e planifikuara përbëhen nga një auditim i planifikuar me Planin Vjetor të Auditimit për 2016 dhe 6 auditime dhe aktivitete të planifikuara me Ndryshimin e Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2016.

Nr.	Lloji i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Përiudha
1.	Auditimi DSHS 12016	Përdorimi i veturave zyrtare dhe shpenzimi i karburanteve	Mars -prill
2.	Percjellja e implementimit DSHS 32016	Rregullorët, politikat dhe udhëzimet për TI	Gusht -Shtator
3.	Auditimi DSHS 42016	Plani i prokurimit dhe Menaxhimi i kontratave	Shtator - Tetor
4.	Auditimi DSHS 92016	Procedurat e prokurimit	Shtator - Tetor
5.	Percjellja e implementimit DSHS 12016	Përdorimi i veturave zyrtare dhe shpenzimi i karburanteve	Tetor
6.	Auditimi DSHS 52016	Të hyrat (të hyrat vetjake) – tarifat	Nëntor
7.	Auditimi DSHS 82016	Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Dhjetor

Tabela 2: Llojet e detyrave dhe aktiviteteteve të auditimit për vitin 2016

Nga 7 auditimet dhe aktivitetet e planifikuara të auditimit në vitin 2016 janë realizuar 6, 4 prej tyre procese të auditimit dhe 2 nga të cilat aktivitete për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve. Nuk është realizuar auditimi “Kompensimet (pagat dhe mëditjet)” për arsye se në vitin 2016 nuk është aprovuar skema e kompensimeve.

Nga raportet e auditimit dhe aktiviteteteve të auditimit për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve janë dhënë 17 rekomandime.

Njësitë e audituara kanë plotësuar planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve dhe nga implementimi i tyre do të bëhet përcjellja e implementimit sipas afateve të parapara.





1.7 Trajnimet e personelit

Duke konsideruar vështirësitë, si ato financiare por edhe ato të karakterit tjetër, si ngjarje kryesore të kësaj periudhe mund të veçojmë përmbylljen me sukses të trajnimeve si në vijim.

Çertifikimi i 3 punonjësve të stafit të Departamentit Meteorologjik

Në periudhën Prill - Shtator 2016, 3 punonjës nga ASHNA, kanë ndjekur kursin fillestar të parashikimit meteorologjik ,IFC (Initial Forecasting Course) ,në Met Office College, Exeter - Britani e Madhe. Që të tre studentët tanë kanë përfunduar kursin me sukses. Ata më pastaj i janë nënshtruar praktikës në punë sipas manualit.



Figura 13: Çertifikimi me sukses i personelit meteorologjik në UK Met Office College





Trajnimi “OJTI Refresher”

Është mbajtur në hapësirat e ASHNA nga data 01/08/2016 deri me 03/08/2017. ASHNA fillimisht kishte arritur një marrëveshje me ofruesin e trajnimit, Institutin CANI nga Çekia. Gjithsejt 11 kontrollorë janë trajnuar. Gjuha e trajnimit si dhe tërë materiali ka qenë në gjuhën angleze. Trajnimi është përmbyllur me sukses.



Figura 14: Trajnimi "OJTI Refresher" në ASHNA - Gusht 2016

Trajnimi rifreskues i Departamentit të KTA

Trajnimi “Recurrent Training” për APP dhe TWR si kërkesë ligjore është organizuar në institutin CANI në Çeki. Trajnimi është ndarë në pesë (5) pjesë; pjesa e parë prej 26.09.2016 deri me 07.10.2016; pjesa e dytë prej 31.10.2016 deri me 11.11.2016; pjesa e tretë prej 14.11.2016 deri me 25.11.2016; pjesa e katërt prej 06.12.2016 deri me 16.12.2016; ndersa pjesa e pestë pritet të filloj dhe përfundoj gjatë muajt Maj 2017. Objektivi i këtij trajnimit ka qenë trajnim rifreskues duke përfshirë teorinë dhe praktikën në simulatorë. Në aspektin teorik, pjesëmarrësit janë azhurnuar me njohuri teorike të procedurave të reja në ASHNA, si; shtrirja e re e aeroportit dhe procedurat e reja, trajtimi i situatave të pazakonshme dhe emergjente. Numri i njësive mësimore në çdo subjekt është planifikuar sipas planit. Ndërsa, në aspektin praktik, pjesëmarrësit janë vënë në situata të tilla për





të ushtruar aftësitë për të lehtësuar rrjedhën e sigurtë të trafikut në ardhje dhe largim në pozitat APS/APP dhe TWR, si të ndajnë dhe njohin situatat emergjente dhe të pazakonshme, si të mbeshtesin pilotin, koordinimin me njësi të involvuara dhe si të aplikojnë procedura korrekte duke përdorur frazeologji korrekte gjithashtu. Trajnimi praktik është bërë në simulatorë. Përformaca e përgjithshme e pjesëmarrësve përgjatë trajnimit simulues ka qenë profesionale. Të gjitha objektivat e temave specifike janë arritur. Ekspertë të kualifikuar kanë mbajtur programin trajnues, menaxhimin, kualitetin si dhe dizajnin e procedurave kontrolluese. Objektivat e trajnimit janë arritur.




Figure 1: Trajnimi rifreskues në Institutin CANI – Çeki

Trajnimi “Assessors Refresh”

Ky trajnim është mbajtur në Institutin CANI në Çeki prej dates 28.11.2016 deri më 30.11.2016. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë tre kontrollorë të trafikut ajror në menyrë që të rivalidohen si vlerësues kompetence. Objektiv i këtij trajnimit ka qenë validimi si Vlerësues në pajtueshmëri me rregulloren e Komisionit (EU) nr 340/2015 si dhe rritja e njohurive esenciale që do t’u mundësoj pjesëmarrësve të kuptojnë rregulloret aktuale të EU në lidhje me privilegjet e Vlerësuesve, për më tepër, pjesëmarrësit kanë rifreskuar njohuritë dhe aftësitë e tyre për të administruar vlerësimet. Ofruesi i trajnimit ka ofruar materialin për trajnim. Numri i njësive mësimore është arritur sipas planifikimit.





Gjithashtu si ngjarje me rëndësi të veçantë mund të përmendim aplikimin për Organizatë Trajnuese në AACK. Kjo organizatë pas certifikimit nga rregullatori, do të operoj në kuadër të ASHNA-së me staf dhe instruktor të certifikuar sipas Competency Assessment Scheme dhe Rregullores së Brendshme, ku DZHT do të luaj rolin kyç në funksionim dhe koordinim të saj. Hapësirat që do t'i shfrytëzoj kjo organizatë janë hapësirat e ASHNA-së, si; Salla e Takimeve, pastaj Kulla dhe Radari etj.

Kjo organizatë trajnuese sipas dispozitave të Rregullores së AACK-së 05/2012, Unit training Plan, Controller Competency Scheme, Planit të Trajnimeve të përgatitur nga DZHT, do të ofroj trajnime për Njesi të KTA-së siq mund të jenë Transitional Training, On the Job Training (OJT) and ATCO Continuation Training.

Vizitat e institucioneve parashkollore dhe shkollore

Përgjatë vitit 2016, ASHNA është vizituar nga një numër i konsideruar i institucioneve edukativo - arsimore. Rreth 700 nxënës gjatë vitit 2016 të mbi 12 institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore të mesme të ulëta nga mbarë vendi me interesim kanë vizituar shërbimet operative të ASHNA-së dhe janë njoftuar me proceset operative dhe shërbimet e sigurta që ofrohen nga ASHNA. Vlenë të theksohet se kërkesat për vizita përgjatë vitit vazhdimisht janë rritur.



Figura 15: Vizitat e shumta të nxënësve në ASHNA





2. Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës

2.1 Indikatorët e performancës së sigurisë

Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës në aspektin e Sigurisë së

ASHNA-s janë paraqitur në formë të Aneksit 1 të këtij Raporti. Në këtë Aneks është paraqitur performansa e Sigurisë kundrejt caqeve të sigurisë.

Në përgjithësi në departamentin e DCSS janë regjistruar:

- a) Ndodhi të kategorisë A (aksidente) - 0
- b) Ndodhi të kategorisë B (incidente) - 5
- c) Ndodhi të kategorisë B (zvogëlim i ndarjes) - 0
- d) Ndodhi të kategorisë C - 57
- e) Ndodhi të kategorisë D - 64, prej të cilave
 - i. Bird strike - 28
 - ii. Laser Attack - 23
 - iii. Prania e kafshëve ne hapësirë manovruese - 6, dhe
 - iv. Të tjera - 7
- f) Hetime të inicuar - 9 (7 të përfunduara, 2 vazhdojnë)




Figura 16: Ndodhitë dhe kategorizimi i tyre përgjat vitit 2016 në ASHNA





2.2 Operimet

Mbarëvajtja e operimeve gjatë vitit 2016, është menaxhuar nga departamentet përkatëse të KTA-së, AIS, MET dhe nën mbështetjen e departamentit të KNV-së, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Manualet e Operimeve të departamenteve gjegjëse. Nuk ka pasë ndonjë problem profesional me ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve.

Të gjitha operimet janë menaxhuar sipas rregullave dhe procedurave dhe sipas kriterëve të caktuar për siguri, efikasitet dhe rrjedhshmëri të rregullt të trafikut.

ASHNA apo sektorët përkatës kanë marrë pjesë në takimet tashmë të zakonshme që lidhen me rrjedhën periodike të operimeve aeroportuale (LIMAK), duke dhënë kontributin e vet me komente për fushat e përbashkëta të operimeve me qëllim të kordinimit sa më efikas.

Koordinimet e ndryshme me J3Air nga KFOR - Headquarter, posaçërisht ato që lidhen me shfrytëzimin e hapësirës ajrore nga përdorues të ndryshëm kanë vazhduar me intenzitetin optimal si në vitet paraprake.



Figura 17: Koordinimi Civilo-Ushtarak

Në prizmin e paraqitjes objektive të suksesit në përgjithësi, operimet komerciale për vitin 2016 kanë shënuar rritje prej 8.1%, ato ushtarake sillen për nga numri ngjashëm me vitin 2016 ndërsa operimet VFR kanë pësuar një rënie prej 7.0%.

Në tabelat (4 dhe 5) si dhe figurat (10 dhe 11) e mëposhtme janë paraqitur kompanitë ajrore që kanë operuar në vitin 2016 në ANP "Adem Jashari" si dhe krahasimi i operativitetit të kompanive të njëjta me vitin paraprak (2015), për bazë kemi marrë kompanitë me mbi 20 operime brenda vitit meqë një numër i konsideruar i këtyre kompanive ka pasur në më pak se 5 operime përgjatë vitit 2016 dhe 2015. Poashtu kemi paraqitur prezencën më të shpeshtë të llojeve të fluturakeve dhe krahasimin me vitin paraprak.





2.2.1 Operimet Komeriale

OPERIMET KOMERCIALE TE MENAXHUARA 2015 - 2016			
2015		2016	
Komerical		Komerical	
Janar	968	Janar	1056
Shkurt	787	Shkurt	910
Mars	910	Mars	1053
Prill	1060	Prill	1172
Maj	1095	Maj	1146
Qershor	1104	Qershor	1234
Korrik	1673	Korrik	1653
Gusht	1701	Gusht	1715
Shtator	1168	Shtator	1262
Tetor	1195	Tetor	1229
Nentor	903	Nentor	931
Dhjetor	932	Dhjetor	1234
TOTAL	13496	TOTAL	14595

Tabela 3: Operimet Komeriale 2015 – 2016





Figura 18: Operimet Komeriale në baza vjetore





2.2.2 Operimet Ushtarake

OPERIMET USHTARAKE TE MENAXHUARA 2015 - 2016			
2015		2016	
Ushtarak		Ushtarak	
Janar	116	Janar	82
Shkurt	114	Shkurt	108
Mars	98	Mars	120
Prill	120	Prill	139
Maj	126	Maj	112
Qershor	111	Qershor	115
Korrik	112	Korrik	86
Gusht	108	Gusht	141
Shtator	130	Shtator	118
Tetor	122	Tetor	135
Nentor	118	Nentor	125
Dhjetor	118	Dhjetor	114
TOTAL	1393	TOTAL	1395

Tabela 4: Operimet ushtarake të menaxhuara





Figura 19: Operimet ushtarake në baza mujore





2.2.3 Operimet VFR

OPERIMET VFR 2015 - 2016			
2015		2016	
Te tjere/VFR		Te tjere/VFR	
Janar	421	Janar	211
Shkurt	493	Shkurt	451
Mars	529	Mars	444
Prill	470	Prill	425
Maj	464	Maj	403
Qershor	437	Qershor	358
Korrik	408	Korrik	386
Gusht	410	Gusht	490
Shtator	353	Shtator	441
Tetor	368	Tetor	377
Nentor	351	Nentor	315
Dhjetor	226	Dhjetor	315
TOTAL	4930	TOTAL	4616

Tabela 5: Operimet VFR 2015 - 2016





Figura 20: Operimet VFR në baza mujore





2.3 Lloji i fluturakeve në ANP “Adem Jashari”

Lloji i fluturakeve dhe shpeshtësia e fluturimit të tyre në ANP "Adem Jashari"												
FLUTURAKET	A-319	A-320	CRJ	B-737	F-100	F-70	DH8	E190	CL60	A-321	Të Tjerë	TOTALI
TOTALI 2015	1838	1726	423	1493	231	97	106	107	94	416	247	6778
TOTALI 2016	2340	1895	374	1223	125	11	82	108	114	744	225	7241

Tabela 6: Krahasimi ndër vite me nr. e llojeve të fluturakeve




Figura 21: Krahasimi 2015 - 2016 i llojit të fluturakeve, operuar në ANP "Adem Jashari"





2.4 Kompanitë Ajrore prezente në ANP

Kompanitë Ajrore - operuar në ANP	2015	2016
ADRIA AIRWAYS	1109	998
GERMANIA AIRLINES	801	882
TURKISH AIRLINES	707	726
EDELWEISS AIR	499	569
AUSTRIAN AIRLINES	544	532
EASYJET	450	501
GERMANWINGS	451	446
PEGASUS AIRLINE	286	282
GERMANIA FLUG	142	275
BELAIR AIRLINES LTD.	203	223
EXPRESS AIRWAYS	125	0
ESY JET UK	0	142
SMARTLYNX AIRLINES	122	133
AIR BUCHAREST	109	118
CROATIA AIRLINES	119	110
SCANDINAVIAN AIRLINES	102	46
SWISS INTER.AIR LINES	101	103
JETAIR FLY	84	61
HELVETIC AIRWAYS	77	28
NORWEGIAN	73	67
AIR BERLIN	62	65
AIR AMERICA JET	55	73
ELMONTEX A.S.	46	0
CORENDON AIRLINES	32	42
SUNEXPRESS	31	29
FREEBIRD AIRLINES	31	23
JETALLIANCE	25	40
TRAVEL SERVICE	24	22
SWISS AIR AMBULANCE	21	26
BULL AIR	0	67
COBREX	0	61
TUIFLY GMBH	0	45
ONURAIR	0	41
EUROWING	0	36
SUNEXPRESS	0	29
ATLASJET AIRLINES	0	29
AVIRO AIR	0	26
TUNINTER	0	25
TRAVEL SERVICE	0	22
FLY365 AVIATION	0	20

Tabela 7: Kompanitë Ajrore me mbi 20 fluturime në ANP "Adem Jashari"






Figura 22: Krahasimi i Kompanive Ajrore prezente në ANP, 2015 - 2016





3. Pasqyra e performansës financiare dhe rezultatet

Ne mendojmë se pasqyrat financiare përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror vazhdon të reformojë sistemet e veta për të optimizuar menaxhimin e rrjedhës së trafikut ajror. Ngritjen e sigurisë dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve do të mund ta sigurojmë përmes përcjelljes së trendeve dhe zhvillimeve të fundit duke u anëtarësuar në organizat ndërkombëtare dhe Evropiane të aviacionit civil siç janë ICAO, EUROCONTROL, CANSO, etj. Vijimi i aktiviteteve të këtyre organizatave me rëndësi kyçe për punën e ASHNA-se.

Pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 të Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Baza e kontabilitetit dhe raportimit në ASHNA është bërë sipas LMFP dhe rregullores MF-Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë së gatshme. Këto pasqyra financiare janë përgaditur për qëllimin e raportimit të aktivitetit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror-ASHNA në pajtim me Legjislacionet në fuqi në Republikën e Kosovës. Menaxhimi i parasë është i organizuar në formën e Llogarise së Vetme të Thesarit, dhe përmes saj është shfrytëzuar mbledhja dhe shpenzimi i parasë ku LLVTH kontrollohet nga ana e Thesarit-MF.

Pasurit e prezantuara janë sipas regjistrimeve në SIMFK ku përfshijnë pasurit me vlerë mbi 1,000€ në pajtim me Rregulloren Financiare 02-2013. Me Ligjin Nr.04/L-250 për themelimin e Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, ASHNA nuk ka mundur ta përfundojë procesin për regjistrimin e pasurive jo financiare të trashëguara nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës-Kontrolli Ajror për regjistrim në SIMFK në vitin 2016. Komisioni i formuar nga ana e Drejtorit të ASHNA-se sipas Rregullores 02-2013 për verifikim dhe regjistrim të pasurive jo financiare, komisioni ka në dispozicion raportin me të dhënat mbi pasuritë jo financiare për regjistrim në SIMF.

ASHNA me ligjin e Buxhetit të vitit 2016 është e përfshirë në buxhetin e Republikës së Kosovës, ku ASHNA si Organizatë e re Buxhetore shpenzimet për vitet paraprake për të bërë krahasimin e tyre me shpenzimet për vitin 2016 nuk ka pasur raporte të paraqitura, sepse me Ligjin për Themelimin e ASHNA-se dhe në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2016 janë pasqyrat e para të prodhuara në bazë të parimit të kontabilitetit në baza të Keshit. Në vijim të këtij raporti vjetor 2016 kemi paraqitur pasqyrat financiare të ASHNA.





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

3.1 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për ASHNA

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Shënime	2016		2016 -1		2016 -2	
	Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit	
	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme
	'000	'000	'000	'000	'000	'000
BURIMET E FONDEVE						
Granti qeveritar	200					
Të hyrat vetanake						
Të hyrat e dedikuara	2,706					
Grantet e përcaktuara të donatorëve						
Huamarrjet						
Fondi zhvillimor në mirëbesim						
Pranimet tjera						
Gjithsej	2,906	-	-	-	-	-
SHFRYTEZIMI I FONDEVE						
Operacionet						
Paga dhe rroga	2	2,200				
Mallra dhe shërbime	3	483				
Shpenzime komunale	4	46				
		2,730				
Transferet						
Transfere dhe subvencione	5					
Shpenzime kapitale						
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	200				
Kthimi i huamarrjeve	7					
Pagesa tjera	8					
Gjithsej	2,930	-	-	-	-	-

Tabela 8: Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme



Njësia Organizative: ZYDR
 Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-RVJ2016
 Ver.: 1.0
 Data e Ver.: 24.03.2017

Faqe 35 nga 59



3.2 Raporti i ekzekutimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ASHNA											
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016											
				2016				2016-1		2016 -2	
